REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 40/23
Datë/Datum. 27.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I *EKSPERTITT SHQYRTUES*

Emri dhe Mbiemri i Ekspertit Shqyrtues	*Nënshkrimi*	*Data e autorizimit të Ekspertit*	*Data e pranimit të autorizimit nga Eksperti*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Daut Retkoceri		*16.01.2023*	*17.01.2023*	*27.01.2023*	40/23

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.01.2023 Operatori Ekonomik: PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA në KOSOVE – Prishtinë ka parashtruar ankesë me numër PSH. Nr. 40/23, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera** me numër të prokurimit: **632-22-11389-5-2-1,** (lënda e përsëritur) iniciuar nga **AK/ – KOMUNA E GJAKOVËS,** kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58 të publikuara përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net me datën 30.12.2022.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës :Shërbime , vlera e parashikuar e kontratës: **202 550,00 €**

Konform nenit 113,114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETËNDIMET ANKIMORE të OE "PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA në KOSOVE – Prishtinë

Dispozitat e shkelura dhe pikat e ankesës.

Neni 1 i LPP-së
Neni7 i LPP-s&
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72i LPP-së
Neni 39 i RRUOPP-së
Rregullorja për çmime jo-normalisht të ulëta.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ne me dt.30.12.2022 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-s, ku e ka rekomanduar për kontratë grupin e OE N.P.SH."Eltoni Com"& ISEFERI SH.P.K., ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të pa suksesshëm.
Sa për rikujtim, AK-ja edhe në vlerësimin e parë (me dt.05.12.2022 e kishte publikuar njoftimin mbi vendimin) e kishte shpallur të njëjtin grup të operatorëve ekonomik fitues, kurse pas kërkesës për rishqyrtim që ne e kishim bërë, AK-ja e kishte aprovuar pjesërisht kërkesën tonë dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim.

Ne kishim pasur qasje në dokumente pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e dt.05.12.2022, ndërsa edhe pas publikimit të njoftimit të dytë me dt.30.12.2022 kemi kërkuar qasje n dokumente, për të analizuar dhe shikuar nëse eventualisht ka pasur ndonjë komunikim apo sqarim me OE e rekomanduar për kontratë.
Me dt.04.01.2023 kemi pranuar qasje në dokumente, konkretisht kemi marr komunikimet ndërmjet AK-së si autoritet kontraktues me OE e rekomanduar për kontratë dhe raportin e rivlerësimit

AK-ja më dt.27.12.2022 i ka kërkuar informata shtesë grupit të OE N.P.SH."Eltoni Com"& ISEFERI SH.P.K në lidhje me inxhinierin z. Kristë Duzhmani, për të cilin janë kërkuar diploma e noterizuar dhe kontrata e punës me punëdhënësin (origjinale apo kopje e noterizuar).

Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar një inxhinier i diplomuar i Elektrikes z. Kristë Duzhmani por duhet të prezantoni diploma (e noterizuar), Kontrata e punës me punëdhënësin për këtë projekt (origjinal ose kopje e noterizuar)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë para datës së hapjes,

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Kërkojmë sqarime sipas nenit 75 të LPP-së për:

Në lidhje me këtë kërkesë për sqarime, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar si dëshmi kontratën dhe diplomën e noterizuar e të cilat kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit, dhe ka bashkangjitur CV e cila kishte qenë e bashkangjitur me dosje por që nuk është sipas kërkesës sepse me këto dëshmi nuk dëshmohet përvoja e punës së inxhinierit në fjalë. Pra edhe pas kërkesës për sqarime OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar diçka konkrete në lidhje me inxhinierin Kristë Duzhmani. Me këtë fakt, është shumë e kuptueshme se nuk ka pasur nevojë të kërkohen sqarime shtesë në lidhje me këtë inxhinier sepse dëshmitë e ofruara për këtë inxhinier nuk janë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.
Nuk dëshmohet në asnjë mënyrë përvoja e punës së këtij inxhinieri sepse nuk ka asnjë referencë të lëshuar për këtë inxhinier. Për më tepër pasi që kontrata është e lidhur vetëm për këtë projekt është dashur të ofrohet kontrata e noterizuar ndërmjet dy palëve ashtu siç është kërkuar në FDT, mirëpo një dëshmi e tillë nuk është ofruar, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm për këtë arsye.

Së bashku me përgjigjen në lidhje me sqarimet janë bashkëngjit edhe dokumentet e inxhinierit të gjeodezisë z. Shkëlqim Brovina si diploma, licenca dhe CV edhe pse licencën e kishte të bashkangjitur së bashku me kontratë me dosje të tenderit. Në lidhje me këtë inxhinier nuk është kërkuar sqarime (në bazë të kërkesës së AK-së për sqarime shtesë).

Ne raportin e rivlerësimit është shënuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues me 09,12.2022 ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit.
Me datë 10.12.202 Autoritet Kontaktues ka nxjerr Vendim ku ka Aprovuar pjesërisht kërkesat dy Operatoreve Ekonomik ankues, dhe lënda është kthyer në rivlerësim, dhe është Anuluar Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Komisioni i rivlerësimit pasi bëri shikimin dhe vlerësimin e dokumenteve, me datë 23.12.2022 dhe me datë 27.12.2022 ka bërë kërkesë për sqarime shtesë konfor nenit

72 Grupi i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë si në vijim: Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar listën e stafit profesional, për inxhinier i diplomuar i Hidroteknikës Z Astrit Salihu por nuk keni prezantuar diplomën e noterizuar (kopje), CV-i, dhe kontratë, për gjeodetin Shkëlqim Brovina nuk keni prezantuar diplomën e noterizuar (kopje) , CV-i dhe referencë, keni prezantuar një inxhinier i diplomuar i Elektrikes z. Kristë Duzhmani por duhet të prezantoni diploma (e noterizuar), me punësim për këtë projekt (origjinal ose kopje e noterizuar). Të gjitha dokumentet duhet të jenë para datës së hapjes. për ti vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:
Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së për;
Përgjigja ose mos përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen përmes platformës së e- prokurimit elektronik deri me dt. 30.12.2022 në ora 16:00
Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet:
Grupi i Operatorëve Ekonomik N.P,SH. "Etoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë me dt.28.12.2022 ka sjellë dokumentet e kërkuara nga AK-ja
Me. 30.12.2022 u mblodh komisioni i vlerësimit pasi bëri shikimin e dokumenteve të prezantuara nga OE erdhi në përfundim se Grupi i Operatorëve Ekonomik N.P.SH."Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë ,është i përgjegjshëm dhe me çmimin me të .ultë
Kriter për dhënie të kontratës është: "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulet", prandaj

Komisioni i rivlerësimit rekomandon që Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com".ISEFERI SH.P.K. Madanaj 50000 Gjakovë, me dhënie të kontratës, pasi që është ofertuesi i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim më të ultë se ofertat konkurruese.

Raporti i rivlerësimit ka kundërthënie ndërmjet veti me kërkesën për sqarime (në bazë të qasjes që kemi pas dhe që na është dhënë, kuptohet), pasi që në kërkesën për sqarime është kërkuar sqarime vetëm për Kristë Duzhmanin, kurse në raport të rivlerësimit shënohet se janë kërkuar sqarime edhe për gjeodetin Shkëlqim Brovinën dhe inxh e Hidros Astrit Salihu.

Sidoqoftë edhe me përgjigje në kërkesën për sqarime, nuk janë ofruar dëshmi konkrete dhe adekuate në raport me këta inxhinier por pothuajse janë përsëritur ato dëshmi.
Ndërsa sa i përket inxhinierit Krisët Duzhmani nuk është dhënë asnjë sqarim në lidhje me kontratën tjetër të bashkangjitur me dosje, e që i njëjti inxhinier e ka me kompaninë Marash Shped SHPK, i cili OE është ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.
Neve gjatë qasjes që kemi pasur, nuk kemi pranuar asnjë dëshmi shtesë në lidhje inxhinierin e hidros Astrit Salihu.
Në raport të rivlerësimit shkruan se:

Me. 30.12.2022 u mblodhe komisioni i rivlerësimit pasi bëri shikimin e dokumenteve të prezantuara nga OE erdhi në përfundim se Grupi i Operatorëve Ekonomik N.P.SH."Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakove ,është i përgjegjshëm dhe me çmimin me të ultë.
Kriter për dhënie të kontratës është; "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë"!

Për neve është e paqartë se çfarë dokumentacioni kanë shikuar komisioni i rivlerësimit, pasi që nuk ka pasur diçka konkrete dhe nuk janë ofruar dëshmi konkrete nga OE i rekomanduar për kontratë.
Siç shihet edhe nga komisioni i rivlerësimit autoriteti kontraktues shkruan se fitues e ka shpallur grupin e operatorëve ekonomik NPSH ELTONI & I SEFERI, prandaj edhe nga ky fakt kuptohet se lider është NPSH ELTONI e jo ISEFERI.

Autoriteti kontraktues edhe pse e kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim, gjatë rivlerësimit nuk ka kërkuar

sqarime shtesë për dëshmi dhe elemente tjera që janë më shumë rëndësi në këtë proces por ka kërkuar sqarime për dëshmi të kufizuara. Pra nuk e ka zbatuar drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, e as nuk është zbatuar neni 61 i LPP-së.

AK-ja nuk ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht të ulëta edhe pse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime substancialisht shumë të ulëta dhe nuk ka asnjë mundësi të argumentohen çmimet e ofertuara nga ky operator ekonomik.

Edhe në vlerësimin e parë e edhe tani AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Tek formulari i tenderit renditja dhe formimi i konsorciumit është bërë në këtë mënyrë

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plotë: Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë, Kosovë

E-mail: eltonigroup@gmail.com

Personi kontaktues: Blerim Ishmaj

Telefoni: 045657360

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **N.P.SH. "Eltoni Com"**

Numri fiskal: **601588504**

Vend-Selia: **Madanaj, 50000, Gjakovë, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **" ISEFERI " SH.P.K.**

Numri fiskal: **810106204**

Vend-Selia: **Gjinoc-Suharekë, 23000, Suharekë, Kosovë**

Tek njoftimi mbi vendimin e AK-së, ofertues në këtë tender është NPSH Eltoni Com&I Seferi SHPK, madfanaj.50000, Gjakovë.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Neni 4.3.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzimeve Operative te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera

Nr. i prokurimit	632-22-11389-5-2-1
Nr i brendshëm	632-22-128-521

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtinë	169313.00€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Horn & Co. Kosova SH.P.K.; Infra-Plus SH.P.K., fshat Lëbushë, 51000, Deçan	186050.00€
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.„Maraxh - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k.; HAGI SH.P.K., Sadik Stavlleci, 50000, Gjakovë	89660.00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë	118800.00€
	///////////	

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna e Gjakovës shpërblen me kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; ISEFERI SH.P.K., Madanaj, 50000, Gjakovë në vlerë totale të ofertës 118800.00€.

Data: 05.12.2022

Emri dhe mbiemri i ZPP: Faton Gutaj

Edhe në raport të vlerësimit dhe rivlerësimit shënohet që fitues është shpallur "NPSH Eltoni Com&I Seferi SHPK Pra nga formulari i tenderit, njoftimi mbi vendimin e AK-së, raportet e vlerësimit kuptohet se lider i grupit të konzorciumit është OE N.P.SH. Eltoni Com dhe jo ISEFERI SH.P.K, pavarësisht faktit që në njërën nga deklaratat e grupit të OE shkruan se lider është OE ISEFERI SH.P.K.
Dihet që lideri dhe anëtarët e konsorciumit caktohen me rastin e ngritjes në sistem të ofertës, aty kërkohet që të deklarohen se kush është lider e kush anëtarë, prandaj në këtë rast shihet që lider është NPSH ELTONI. Këtë e parasheh edhe Manuali për OE përgatitja dhe dorëzimi i ofertës.

Edhe përkundër faktit që në njërën nga deklaratat e konzorciumit lider është caktuar ISEFERI SH.P.K., në autorizimin e lëshuar nga grupi i OE të rekomanduar, është autorizuar personi z. Blerim Islamaj i cili është menaxher i kompanisë Eltoni Com. i njëjti nga autorizimi i prezantuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë shihet se është i autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit, apo për të ofruar informata shtesë mbi të. Gjithashtu i njëjti është i autorizuar për të nënshkruar edhe kontratën në rast se kjo kompani shpallet fituese, fakt ky që nënkupton se kontrata do të nënshkruhet nga OE Eltoni Com dhe jo nga ISEFERI SHPK.

Nga faktet e lartcekura, kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë janë munduar të manipulojnë me deklaratat e konsorciumit, ku në njërën nga deklaratat shkruan se OE ISEFERI SHPK caktohet lider i grupit, mirëpo në të gjitha dëshmitë dhe dokumentet tjera si "lidhja e ofertës, njoftimi mbi vendimin, formulari i tenderit, raportet e vlerësimit dhe nga autorizimi i lartcekur, shihet se lideri i këtij grupi të OE është NPSH Eltoni Com dhe jo ISEFERI SHPK.

AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Grupi i OE të ekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm, sepse nuk i kanë plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, përkatësisht kërkesën si në vijim "Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Ne një vlerë prej jo më pak se 295.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme", ku si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar punët e kryera shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mire të punëve - (referencë ose raport të pranimit të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-reference"

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura, ku e shpjeguam qartë se lider i grupit të OE është NPSH Eltoni Com, atëherë kërkesa e lartcekur nuk është plotësuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, pasi që kërkesa ka qenë që në rast të grupit të OE lideri duhet të ofroj 60% e kontratave. OE NPSH Eltoni Com ka prezantuar një listë të kontratave ku vlera totale e kontratave është në shumën 110,270.00€. Lista e prezantuar nga OE NPSH Eltoni Com nuk e plotëson kërkesën që lideri të posedoj 60% të kontratave, pasi që 60% i vlerës së kërkuar është në shumën 177,000.00 €.

Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësoj kërkesën e lartcekur edhe për faktin se edhe anëtari i konsorciumit ISEFERI SHPK, nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka përfunduar kontrata të natyrës së ngjashme. i njëjti OE në ofertë ka prezantuar kontrata për ndërtim të rrugëve, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me rrënime të objekteve dhe jo ndërtim të rrugëve. Andaj kontratat e të njëjtit nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohen as të ngjashme.
Pavarësisht faktit që lideri i grupit të OE është NPSH Eltoni Com edhe anëtari tjetër i grupit nuk ka prezantuar dëshmi se i

njëjti ka përfunduar kontrata të natyrës së ngjashme.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe si përfundim i njëjti është i papërgjegjshëm.

Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkesa ka qenë "Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 390.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të pakten 0% të vlerës së qarkullimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar
"Deklaratat Tatimore
Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 (tri) vitet e fundit (kopje)".
Kërkesa e lartcekur specifikon qartë se lideri i grupit duhet ti posedoj 60% të qarkullimit, ndërsa lideri i grupit të OE NPSH Eltoni Com nuk ka prezantuar në ofertë asnjë dëshmi në lidhje me qarkullimin bankar dhe si i tillë i njëjti është i papërgjegjshëm, pasi që nuk e plotëson kërkesën e lartcekur.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e kanë plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë "një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë (origjinal ose e noterizuar)".*

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë përkatësisht lideri i grupit OE NPSH Eltoni Com, në listën e stafit si inxhinier për kërkesën e lartcekur ka prezantuar z. Astrit Salihun, mirëpo për të njëjtin nuk është ofruar asnjë dëshmi sipas kërkesës së lartcekur (pretendim i cekur edhe më lartë).
Pra i njëjti figuron vetëm në listë të stafit, ndërsa për të nuk janë prezantuar dëshmitë e kërkuara si diploma e noterizuar, CV-ja, referencat dhe as kontrata e punës e noterizuar ndërmjet palëve, fakt ky që tregon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe si i tillë është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku është kërkuar "d.) një gjeodet ose teknikë Gjeodezisë (gjeometër) me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë (origjinal ose e noterizuar)".*
Për kërkesën e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë, përkatësisht lideri i grupit të OE NPSH Eltoni Com ka prezantuar në listën e stafit si inxhinier të gjeodezisë z. Shkelqim Brovina. Për të njëjtin në ofertë OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar si dëshmi licencën e gjeodetit, kontratën (jo të noterizuar ndërmjet palëve) dhe letërnjoftimin, mirëpo nuk e ka prezantuar diplomën, referencat dhe CV-në për të njëjtin (pretendim i cekur edhe më lartë).

Ndërsa në kërkesën e lartcekur është kërkuar decidivisht që duhet të prezantohet diploma, CV dhe referencat, andaj përderisa dëshmitë e tilla nuk janë prezantuar për të njëjtin, kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe njëkohësisht është OE i papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur ta konsideroni edhe ju, mirëpo që një veprim të tillë nuk e keni bërë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë për kërkesën "një inxhinier i diplomuar apo master i elektroteknikës me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit", ka prezantuar në ofertë z. Kristë Duzhmani, për të cilin ka prezantuar diplomën e të njjtit, mirëpo që nuk ka prezantuar referenca dhe CV sipas kërkesës s dosjes së tenderit. Po ashtu për të njëjtin inxhinier OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy kontrata pune në ofertë. Njëra është e lidhur në mes të NPSH Eltoni Com dhe Kristë Duzhmanit, ndërsa tjetra kontratë është e lidhur ndërmjet kompanisë Marash Shped SHPK, i cili OE është ofertues në këtë aktivitet të prokurimit (pretendim i cekur dhe sqaruar edhe më lartë).

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesën në lidhje me inxhinierin e elektroteknikës, pasi që për të njëjtin nuk janë prezantuar referencat dhe CV-ja dhe po ashtu janë ofruar dy kontrata të me dy kompani.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar" *d.) Një Autovinç"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi deklaratat unike doganore ose kontrata apo fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen".*
Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur në lidhje me autovinçin, pasi që në ofertë nuk ka prezantuar dëshmi që i njëjti e posedon autovinçin e kërkuar. Kur analizohet oferta e të njëjtit në asnjërin nga dokumentet e prezantuara në ofertë nuk figuron autovinçi, andaj përderisa nuk është prezantuar asnjë dëshmi për të njëjtën paisje, atëherë kuptohet qartë fakti se i njëjti OE është i papërgjegishm. Autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt, pasi që edhe përkundër faktit që i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi se posedon autovinëin e kërkuar, përsëri e ka rekomanduar për kontratë, duke e favorizuar haptas të njëjtin OE.

Gjithashtu tek deklarata nën betim e liderit të konsorciumit emri i përfaqësuesit është Behat Seferaj, ndërsa në dokumentet e kompanisë askund nuk figuron se një person i tillë ka ndonjë rol menaxhues tek kompania NPSH Eltoni Com.

Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë është OE i papërgjegjshëm sepse i njëjti ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët, ndërsa këtë fakt e vërteton tabela e mëposhtme:

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta të përgjegjshme	**Pranuar 3 oferta të përgjegjshme**		
2		1. PE-VLAKU SH.P.K. Dega në Kosovë	169,313.00	
3		**2. Grupi i OE NPSH Eltoni Com & ISEFERI SH.P.K.**	**118,800.00**	
4		3. Grupi i OE Horn & Co Kosova SH.P.K. & Infra-plus SH.P.K.	186,050.00	
5		**Total (C2+C3+C4)**	**474,163.00**	
6		**mesatarja (C5/3)**	**158,054.33**	
7	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**121,580.25**	ne ketë rast vetëm oferta nr.2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
8	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**153,920.90**	ne ketë rast oferta me nr.2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta të përgjegjshme
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve.
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit** të dytë **më** të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet.
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët**	

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është ofertë me çmim jo normalisht të ulët, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh këtë fakt, kurse e ka rekomanduar për kontratë të njëjtin.

Me veprimin e lartcekur, AK-ja nuk e ka respektuar nenin 61 të LPP-së, pasi që nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së dhe Rregullores për çmime jo normalisht të ulëta.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura në këtë kërkesë për rishqyrtim kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar

për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe i njëjti nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu edhe grupi i OE N.T.SH. "Marash -Shped" SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K. & HAGI SH.P.K., janë të papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, ku është kërkuar "d.) një gjeodet ose teknikë Gjeodezisë (gjeometër) me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë (origjinal ose e noterizuar)".*
Për kërkesën e lartcekur OE i lartcekur, ka prezantuar në listën e stafit si inxhinier të gjeodezisë z. Agron Balaj. Për të njëjtin në ofertë OE i lartcekur nuk ka prezantuar si dëshmi diplomën, dhe kontratën.
Ndërsa në kërkesën e lartcekur është kërkuar decidivisht që duhet të prezantohet diploma, CV kontrata e punës dhe referencat, andaj përderisa dëshmitë e tilla nuk janë prezantuar për të njëjtin kuptohet qartë se grupi i OE të lartcekur nuk e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe njëkohësisht është OE i papërgjegjshëm.

Gjithashtu i njëjti OE për kërkesën "*një inxhinier i diplomuar apo master i elektroteknikës me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit*", ka prezantuar në ofertë z. Kristë Duzhmani, mirëpo që CV-ja e të njëjtit është e pa nënshkruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Të njëjtit nuk mund dhe nuk është dashur ti kërkohen sqarime shtesë për shkak se nënshkrimi i CV-së nuk mund të vërtetohet objektivisht sipas nenit 72.3 të LPP- së, që e njëjta ka ekzistuar para datës së hapjes së ofertave. Po ashtu neni 39 i RRUOPP-së e parasheh qartë " CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar sqarime shtesë.

Po ashtu i njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë "një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë (origjinal ose e noterizuar)"*
Grupi i OE të lartcekur, në listën e stafit si inxhinier për kërkesën e lartcekur ka prezantuar z. Astrit Salihun, mirëpo për të njëjtin nuk është ofruar diploma e noterizuar, të njëjtit i mungon edhe kontrata dhe CV-ja. Pra duke u bazuar në këto fakte kuptohet që i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm.

Grupi i OE të lartcekur është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar "d) Një Autovinç" ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi deklaratat unike doganore ose kontrata apo fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen*".
Grupi i OE të lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartcekur në lidhje me autovinçin, pasi që në ofertë nuk ka prezantuar certifikatën e regjistrimit të autovinçit, me anë të së cilës tregohet se i njëjti ka afat valid të regjistrimit.

OE i lartcekur përveç faktit që është i papërgjegjshëm për faktet e lartcekura, i njëjti është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar përgjigje në sqarimet që AK-ja i ka bërë të njëjtit OE.

Me dt. 11.01.2023 ne kemi pranuar vendimin e AK-së në lidhje me kërkesën për rishqyrtim, ku e ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se: *"Autoriteti kontraktues sqaron se lideri i grupit është ISEFERI SHP.K. sepse për këtë ka një marrëveshje*

të nënshkruar dhe vulosur nga të dyja anëtarët e konzorciumit. Lidhur me sqarimet e ofruara nga grupi i OE NPSH ELTONI COM dhe ISEFERI SHPK, autoriteti kontraktues mendon se janë të mjaftueshëm dhe mangësitë në sqarimet e ofruara janë devijime të vogla, prandaj vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit".

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm pasi që nga të gjitha faktet që i kemi bashkangjitur në kërkesën për rishqyrtim e edhe tani në ankesë, kuptohet qartë se lider i grupit të konsorciumit është NPSH ELTONI dhe jo ISEFERI, mirëpo AK-ja me qëllim të favorizimit të OE të rekomanduar për kontratë nuk po i merr parasysh fare pretendimet tona të cilat janë të bazuara në fakte dhe dëshmi konkrete.
Pa marr parasysh marrëveshjen, formimi i konsorciumit në platformën e prokurimi e tregon qartë kush është lideri, e që kur analizohet formulari i tenderit aty shihet qartë se lider i grupit të OE është NPSH Eltoni Com dhe jo ISEFERI siç pretendon AK-ja.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera të ngritura nga ne në kërkesën për rishqyrtim AK-ja jep një arsyetim krejtësisht të pa bazuar, duke mos dhënë fakte konkrete në lidhje me pretendimet tona, mirëpo vetëm e cek se *"autoriteti kontraktues mendon se janë të mjaftueshëm dhe mangësitë në sqarimet e ofruara janë devijime të vogla, prandaj vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit".*
Nga ky arsyetim i AK-së vete njëjta e pranon që në sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë kanë mangësi, mirëpo që ky fakt AK-së nuk po i lë përshtypje pasi që sipas saj këto janë devijime të vogla. Në këtë rast nuk kemi të bëjë fare me devijime të vogla pasi që ne e kemi cekur qartë se raporti i rivlerësimit ka kundërthënie ndërmjet veti me kërkesën për sqarime (në bazë të qasjes që kemi pas dhe që na është dhënë, kuptohet), pasi që në kërkesën për sqarime është kërkuar sqarime vetëm për Kristë Duzhmanin, kurse në raport të rivlerësimit shënohet se janë kërkuar sqarime edhe për gjeodetin Shkëlqim Brovinën dhe inxh e Hidros Astrit Salihu.

Po ashtu me përgjigje në kërkesën për sqarime, nuk janë ofruar dëshmi konkrete dhe adekuate në raport me këta inxhinier por pothuajse janë përsëritur ato dëshmi, pra nuk janë ofruar dëshmitë konkrete që tregojnë qartë se a janë përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Devijim i vogël nuk mund dhe nuk duhet të quhet mos prezantimi i dëshmive të kërkuara, andaj si i tillë konstatimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe për më tepër është vetëm favorizim hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë.

AK-ja gjithashtu nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tona ankimor të cilat i kemi parashtruar në kërkesën për rishqyrtim. E njëjta po ashtu gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit nuk ka kërkuar fare sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta edhe pse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime substancialisht shumë të ulëta dhe nuk ka asnjë mundësi të argumentohen çmimet e ofertuar nga ky operator ekonomik.

Me veprimin e AK-së për mos shqyrtimin e pretendimeve tona në tërësi, kuptohet qartë fakti se AK-ja pasi që nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimor, e njëjta nuk ka dhënë përgjigje fare, ku ky fakt tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të qëndrueshme, pasi që në të kundërtën AK- ja do ti kundërshtonte me fakte dhe dëshmi konkrete.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht është favorizim i hapur kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.
Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi I.1 i LPP-së, sepse e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA në KOSOVE** si dhe të **ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP- së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Dëmet materiale:

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITËRET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04 L-237, ligjin nr. 05 L-068 dhe ligjin nr. 05 L-092, neni 65	Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.	Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit

	të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).
Vërtetim nga Gjykata kompetente.	Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 & 7.2	
Përshtatshmëria profesionale:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.	Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK	Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2	
Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 390.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.	Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 (tri) vitet e fundit (kopje)
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2	
